

R A P O R T
I EKSPERTIT KONTABEL TE REGJISTRUAR
PER LIKUIDIMIN E SHOQERISE
"ALBA FASHION GROUP SHPK"

Une, Artan Golemi me profesion Auditues Ligjor, jam caktuar me vendimin e Asamblese se Ortakeve te shoqerise "ALBA FASHION GROUP SHPK SHPK", date 13.05.2019, si LIKUIDATOR ne procesin e prishjes se shoqerise nepermjet procesit te likuidimit. Sipas Procesverbalit te Asamblese se Zakonshme te Ortakeve te ALBA FASHION GROUP SHPK te datës 13.05.2019, kjo e fundit ka vendosur per mbylljen aktivitetit.

Shoqeria "ALBA FASHION GROUP SHPK" me adresen: Ndertese 3 kateshe, Zk nr.1812. me pasuri nr.46/34/1 Lezhe Lac Rruga Kryesore, eshte rregjistruar prane zyres se rregjistrimit (QKB), me numer NIPT: L87719301O date 19.03.2018. Sipas ketij vendimi kontributi ne kapitalin e shoqerise eshte ofruar nga ALBA FASHION GROUP Shpk.

Vleresimi dhe opinionimi im, me cilesine e Audituesit Ligjor, eshte lidhur me sinqeritetin dhe vertetesine e gjendjes se llogarive kontabel me 30 Nentor 2019 te cilat mundesojne realizimin e procesit te likuidimit.

Per te realizuar misionin, qe me eshte besuar jam mbeshtetur:

Baza ligjore;

- Ligji Nr.9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare",
- Ligji Nr. 9228 date 29.04.2004 "Per Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare",
- Vendimin e Shoqerise "ALBA FASHION GROUP SHPK" te datës 16/12/2019,
- Statutin dhe Akt-Themelimin e shoqerise "ALBA FASHION GROUP SHPK".

Dokumentacioni;

- Bilanci i shoqerise, mbyllur me 30 Nentor 2019.
- Verifikime te ngjarjeve pas mbylljes se bilancit deri me 30 Nentor 2019.
- Verifikime e sondazhe te dokumentacionit baze kontabel e ligjor, per periudhat e mesiperme.

Pergjegjesite ligjore:

Pergjegjesia per perгатitjen e deklarave financiare, pasqyrave te te ardhurave dhe shpenzimeve, te deklarimeve financiare dhe te anekseve qe shoqerojne ato, eshte e drejtimit te shoqerise.

Pergjegjesia ime eshte te jap opinionin tim me nje siguri te mjaftueshme lidhur me sinqeritetin dhe vertetesine e rezultatit financiar qe mbyllet me 30 Nentor 2019.

Baza e opinionit:

Opinionimi im si Auditues Ligjor, lidhur me sinqeritetin dhe vertetesine e llogarive te shoqerise "ALBA FASHION GROUP SHPK", realizohet duke u bazuar ne Standartet Nderkombetare te Auditimit, parimet, normat dhe rekomandimet profesionale te Audituesve Ligjore. Per kete qellim kam bere, verifikime e sondazhe mbi deklarimet financiare te raportuara nga shoqeria, duke perdorur metodat

dhe teknikat profesionale me qellim dhenien e nje sigurie te mjaftueshme per vertetesine e llogarive dhe gjendjes pasurore te shoqerise "ALBA FASHION GROUP SHPK", te paraqitura sipas deklaratave financiare te mbyllura me 30 Nentor 2019.

Te nderuar Zj./Z., perdorues te ketij raporti,

I caktuar me cilesine e Audituesit Ligjor, per vleresimin e deklaratave financiare, me qellim likuidimin e shoqerise, sa meposhte paraqes opinionin tim:

Shoqeria "ALBA FASHION GROUP SHPK" me NIPT: L87719301O ka zhvilluar aktivitetin e saj ne Ndertesen 3 kateshe, Zk nr.1812. me pasuri nr.46/34/1, Lezhe Lac Rruga Kryesore. Kam verifikuar bilancin e shoqerise te mbyllur me 31 Dhjetor 2018 para likuidimit te shoqerise "ALBA FASHION GROUP SHPK" i cili paraqitet si me poshte:

AKTIVI	31.12.2018	PASIVI	31.12.2018
A.AKTIVE MATERIALE		A.KAPITALET E VETA	
Aktive Afatgjata materiale	0	Kapitali i Nenshkruar	100,000
Toka,Troje,Ndert.Inst.pergj.	0	Prime te lidhura	0
Instal.teknike,makine,paisje	0	Rezervat	0
Amortizime (-)	0	Fitime/H. te mbartura	0
		Fitime/H. te ushtrimit	(280,610)
B.AKTIVE AFATSHKURTRA		B. DETYRIMET	
Likujditete	237	Detyrime ndaj punonjesve	0
Te arketueshme te tjera	43,488	Detyrime tatimore	21,009
Inventari	0	Te tjera afatshkurtra	203,326
TOTALI I AKTIVIT	43,725	TOTALI I PASIVIT	43,725

Pra, sikurse shihet edhe nga bilanci, i mbyllur me 31 Dhjetor 2018 aktivet, kapitali, rezervat dhe fitimet neto perbehen :

- a. Shoqeria ka gjendje likujditete shumen prej 237 leke;
- b. Te arketueshme per shumen 43,488 leke perfaqesojne vlerën e TVSH-se se kreditueshme te shoqerise;
- c. Shuma prej 280,610 leke perfaqeson humbjen e vitit ushtrimor ne kete date;
- d. Shuma prej 224,335 leke perfaqesone detyrimet qe shoqeria i ka ortakeve (203,326 Leke) ne kete date te bilancit si dhe detyrimet per sigurime shoqerore dhe shendetesore.
- e. "ALBA FASHION GROUP SHPK Shpk" ka financuar aktivitetin e shoqerise dhe likuiditetet 237 Leke dhe te arketueshmet qe ajo ka 43,488 Leke mbulojne humbjet e shoqerise ne masën 43,725. Ortaket heqin dore nga detyrimi qe ka shoqeria ndaj tyre.

Komente:

Nga verifikimet e dokumentacionit baze kontabel, rregjistrimit te tyre ne librat e kontabilitetit dhe pasqyrimet e deklarimit sintetik te tyre ne bilancet kontabel, pasqyrat e te ardhurave dhe shpenzimeve si dhe anekseve qe shoqerojne ato, konstatoj se eshte i rregullt dhe i vertete.

Bazuar sa me siper, bazuar ne Ligjin Nr. 9901 date 14.04.2008 " Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" nenet 190-205 dhe ne vendimin e shoqerise "ALBA FASHION GROUP SHPK", te dates 13/05/2019 per likuidimin e shoqerise, paraqes bilancin e shoqerise me date 30/11/2019, i cili do te konsiderohet edhe si bilanc i momentit te likuidimit te saj.

Bilanci i shoqerise "ALBA FASHION GROUP SHPK" ne momentin e likuidimit do te paraqitet si me poshte:

AKTIVI	30.11.2019	PASIVI	30.11.2019
A.AKTIVE MATERIALE		A.KAPITALET E VETA	
Aktive Afatgjata materiale	0	Kapitali i Nenshkruar	100,000
Toka, Troje, Ndert. Inst. pergj.	0	Prime te lidhura	0
Instal. teknike, makine, paisje	0	Rezervat	0
Amortizime (-)	0	Fitime/H. te mbartura	(280,610)
		Fitime/H. te ushtrimit	(138,976)
B.AKTIVE AFATSHKURTRA		B. DETYRIMET	
Likujditete	0	Detyrime ndaj punonjesve	0
Te arketueshme te tjera	0	Detyrime tatimore	0
Inventari	0	Te tjera afatshkurtra	319,586
TOTALI I AKTIVIT	0	TOTALI I PASIVIT	0

Bilanci i mesiperm paraqet nje pamje reale te gjendjes pasurore dhe gjendjes financiare te shoqerise "ALBA FASHION GROUP SHPK" ne momentin e likuidimit.

Pra, sikurse shihet edhe nga bilanci, i mbyllur me 30 Nentor 2019 aktivet, kapitali, rezervat dhe fitimet neto perbehen :

Pasivi	Leke
Kapitali i Nenshkruar	100,000 leke
Humbje deri me 30.11.2019	(419,586) leke
Detyrime ndaj ortakeve	319,586 leke

Pra me kapitalin e nenshkruar dhe detyrimet qe shoqeria i ka ortakeve ne daten e likuidimit do te mbulohen humbjet e mbartura deri ne kete date.

Perfundimisht opinioni im si Auditues Ligjor eshte :

Shoqeria priset konform dispozitave ne fuqi, te statutit dhe aktit te themelimit te saj.

Ajo nuk ka asnje lloj detyrimi me klientet apo furnitore, nuk ka detyrim per te ardhura personale dhe sigurime shoqerore.

Si konkluzion Shoqeria Tregtare "ALBA FASHION GROUP SHPK", nuk ka asnje detyrim si kundrejt shtetit ashtu dhe ndaj te treteve ne momentin e likuidimit.

Persa me siper shoqeria mund te likujdohet,

Te likujdohet.

Auditues Ligjor

Artan Golemi, Likuidator

License I.E.K.A. Nr. 80,

License tatimore NIPT K31712103L

Tirane me, 28/01/2020

Ekspert Kontabël Autorizuar
ARTAN GOLEMI
TIRANË ALBANIA